

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**  
**P. Nr. 36/2010**  
**23 Shkurt 2011**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjykses, Gjyqtaret e EULEX-it Jonathan Welford-Carroll dhe Caroline Charpentier si Anëtar të Trupit Gjykses me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Tara Khan, si Proccsmabajtese, në Lëndën Penale kundër;


**\_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_**, të akuzuar sipas Aktakzës së Prokurorisë Speciale PPS Nr. 23/2010 të datës 13 Korrik 2010 dhe e parashtruar në Sekretarinë e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me 16 Korrik 2010, siq është konfirmuar me Aktvendimin KA.Nr 56/2010 mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 07 Shtator 2010 me veprat penale në vijim;

- **Krim i Organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 Paragrafi (3) i KPK.
- **Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229, Paragrafi (2) dhe Paragrafi (4) Pika (i) i KPK.**

**\_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_**, të akuzuar sipas Aktakuzës së lartpërmendur PPS.Nr.23/2010, siq është vërtetuar me Aktvendimin KA. Nr. 56/2010 mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 07 Shtator 2010 me veprat penale në vijim;

- **Krim i Organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 Paragrafi (1) i KPK.
- **Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229, Paragrafi (2) dhe Paragrafi (4) Pika (i) e KPK.**

Pas mbajtjes publike të Gjykimit Kryesor më 08 dhe 09 Dhjetor 2010, 04 dhe 05 Janar 2011 dhe 01, 02, 03, 10, 11 dhe 22 Shkurt 2011 të gjitha të mbajtura në presencë të të akuzuarëve **\_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_** avokatëve të tyre Mahmut Halimi, Adem Vokshi (i zëvendësuar nga Bedri Murrati më 22 dhe 23 Shkurt), Kole Ramaj dhe Mehmed Hasani, dhe Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, pas pleqnimit dhe votimit të Trupit Gjykses të mbajtur më 23 Shkurt 2011 sipas Nenit 392 Paragrafi (1) i KPK, më 23 Shkurt 2011 publikisht dhe në presencë të të gjithë të Akuzuarëve, Avokatëve Mbrojtës dhe Prokurorit Publik të EULEX-it, ka shpallur këtë



## AKTGJYKIM

**I Akuzuari** [redacted] pa pseudonim, djali i [redacted] dhe [redacted] i lindur më [redacted] 1957 në fshatin [redacted] Kosovë, i perkatësisë etnike Shqiptare, banor i [redacted] i martuar, baba i katër fëmijëve të rritur dhe i fëmijës së pestë të moshës 17 vjecare, që jeton në të njejtën shtëpi pa të ardhura, ka të kryer shkollën e mesme, mekanik i veturave, kur i punësuar ka të ardhura mujore 300-500 Euro, i gjendjes mesatare ekonomike, i padënuar më pare, në paraburgim që nga 22 Shkurt 2010.


**I Akuzuari** [redacted], me pseudonim [redacted], djali i [redacted] dhe [redacted] i lindur më [redacted] 1975 në fshatin [redacted], komuna e [redacted] Kroaci, me etnicitet nga Bosnia, shtetase e Bosnia dhe Hercegovina, [redacted] [redacted] BeH, i divorcuar, baba i katër fëmijëve nga mosha 6 mujore deri në 14 vjecare, ka të kryer shkollën fillore, mekanik i veturave, me të ardhura mujore 1000 Euro, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar me parë në Kroaci për Bartje Ilegale të Personave Përtej Kufirit Shtetëror, në paraburgim që nga data 03 Shkurt 2010;

**I Akuzuari** [redacted] pa pseudonim, djali i [redacted] dhe [redacted] i lindur më [redacted] 1991 në Mitrovicë, Kosovë, Shqiptar Etnik, me vendbanim në Rrugën [redacted] i martuar, baba i një fëmije 1 vjecare, bashkëjeton me prindërit në të njejtën shtëpi, i papunë, pa të ardhura personale, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, i padënuar më pare, në paraburgim prej 03 Shkurt 2010 deri më 21 Prill 2010 e që nga atëherë në arrest shtëpiak

shpallen

## FAJTORË

- Sepse ndërmjet Tetorit 2009 dhe 03 Shkurt 2010 ata si pjesë e grupit të organizuar, në role të caktuara kanë marrë pjesë në transportim, shpërndarje dhe shitje për përfitim nga disa dërgesa të substancave narkotike të dërguara nga Shqipëria në Kosovë, e pastaj përmes Serbisë me destinacion në BeH. I akuzuari [redacted] ka pasur rolin e organizatorit kryesor në grup ku ai ka qenë lidhja koordinuese ndërmjet dy anëtarëve të panjohur Shqiptar të grupit [redacted] dhe [redacted], i akuzuari [redacted] dhe i akuzuari [redacted]. Dy Shqiptarët i kanë sjellur marihuana në sasi të panjohur në rezidencën e të akuzuarit [redacted] në Mitrovicë, në rrugën 20 Pjeter Budi, ku [redacted] dhe [redacted] e kanë matur dhe e kanë mbeshtjellur atë në paketime më të vogla e pastaj e kanë vendosur atë në paketime më të mëdha dhe ato i kanë vendosur në garazhë të shtëpisë prej nga dy burra të panjohur i kanë marrë dhe i kanë shpërndarë me vetura të ndryshme në destinacion të panjohur. Më 03 Shkurt 2010, 26.449 kg të kanabisit (marihuana) dhe 4.342 kg të një substance të kafës të qelë që me përmbajtje të një përzierje të Acetaminophen (Paracetamol) dhe Kafëne që mund të përdoret si përzierje të Heroines dhe janë gjetur përzierje të drogës së grupit Opiate. Më tutje, gjurmë



të heroinës janë gjetur në matësen digjitale, një site dhe kullojse të konfiskuar nga shtëpia e [redacted] Sasia përgjithshme e drogës së transportuar është ende e panjohur.

Me një veprim të tillë i akuzuari [redacted] ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal të

**Krimit të Organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 Paragrafi (3) KPK dhe **Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike** në kundërshtim me Nenin 229, Paragrafi (2) dhe Paragrafi(4) Pika (i) e KPK.

Të akuzuarit [redacted] dhe [redacted] kanë kryer dhe janë penalisht përgjegjës për veprimin kriminal të

**Krimit të Organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 Paragrafi (3) KPK dhe **Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike** në kundërshtim me Nenin 229, Paragrafi (2) dhe Paragrafi(4) Pika (i) e KPK.

**E akuzuara** [redacted] pseudonimi [redacted] vajza e [redacted] dhe [redacted], e lindur më [redacted] 1988 në [redacted] Bosnia dhe Hercegovinë, banore e qytetit [redacted] BeH, me etnicitet Bosnjake, shtetase e BeH, beqare, me një fëmijë të moshës 6 muajshe, ka të kryer shkollën e mesme, studente pa të ardhura personale, e mbajtur nga prindërit, e gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të njohur ndonjë denim te meparshem kundër saj, në paraburgim prej datës 03 Shkurt 2010


Shpallet

### E PAFAJSHME

- Sepse nuk është vertetuar se ajo ka qenë pjesë e grupit të organizuar që ka kryer veprat penale apo që te ketë marrë pjesë në ndonjë mënyre në shpërndarje, transportim apo shitje të drogës.

Prandaj sipas Nenit 390 Pika 3) e KPPK e akuzuara [redacted] lirohet nga akuzat

**Krimit të Organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 Paragrafi (3) KPK dhe **Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike** në kundërshtim me Nenin 229, Paragrafi (2) dhe Paragrafi(4) Pika (i) e KPK.



I akuzauri 

### DËNOHET

- Me tete /8/ vjet burg dhe gjobë prej 50.00 Euro për veprimin kriminal të Krimin të Organizuar
- Me tri /3/ vjet burg dhe gjobë 50.00 Euro për veprimin kriminal Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike

Denimi i përbashkët percaktohet me dhjetë vjet /10/ burg dhe gjobë prej 51.00 Euro, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 dhe 4 e KPK.

Koha e kaluar ne paraburgim nga 22 Shkurt 2010 do të numerohet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) e KPK.

I akuzuar: 

### DËNOHET

- Me shtate /7/ vjet burg dhe gjobë prej 50.00 Euro për veprimin kriminal të Krimin të Organizuar
- Me tri vjet /3/ burg dhe gjobë prej 50.00 Euro për veprimin kriminal Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike.

Denimi i përbashkët percaktohet ne tetë /8/ vjet burg dhe gjobe prej 51.00 Euro, sipas Nenit 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 dhe 4 i KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga 03 Shkurti 2010 do numërohet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

I akuzuari \* 

### DËNOHET

- Me tri /3/ vjet burg dhe 50.00 Euro gjobë për veprimin kriminal të Krimin të Organizuar
- Me /2/ vjet burg dhe 50.00 Euro gjobë për veprimin kriminal Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike.



**Denimi i përbashkët percaktohet në katër /4/ vjet burg dhe 51.00 Euro gjobe sipas Nenit 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pikat 2 dhe 4 te KPK.**

Koha e kaluar në paraburgim prej 03 Shkurt 2010 deri 21 Prill 2010 dhe koha e kaluar në arrest shtepiak nga data 22 Prill 2010 do të numërohet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) KPK.

Sasia prej 26.449 kg të kanabisit dhe 4.342 kg të substancës në formë pluhuri ngjyrë të kaftë të qelë që perbene nje perzierje të Acetaminofenin/Paracetamol dhe Kaffeine, 7,530 Euro dhe 230 Marka BeH te kapura nga i Akuzuari [redacted] konfiskohen sipas Nenit Article 60 Paragrafi (1) I KPK dhe Nenit 494 Paragrafi (1) i KPK.

1,600 Eurot të konfiskuara nga e Akuzuara [redacted] do ti kthehen [redacted]

I Akuzuari [redacted] i Akuzuari [redacted] dhe i Akuzuari [redacted] do ti mbulojne pjesët e shpenzimeve te procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPK me perjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim. Një Aktvendim i veçantë për shumën e shpenzimeve do të merret nga Gjykata pasi që të merren të dhenat e tilla sipas Nenit 100 Paragrafi (2) te KPK

Sipas Nenit 103 Paragrafi (1) të KPPK shpenzimet për Proceduren Penale sipas Nenit 99 Paragrafi (2) Nen-paragrafët 1 deri 5 te KPPK shpenzimet e nevojshme të të Akuzuares [redacted] dhe mbulimi i shpenzimeve të nevojshme për Avokatin Mbrojtës si dhe shpenzimet për përkthim gojor dhe me shkrim do te paguhen nga burimet bugetore.

## ARSYETIMI

### A. Historia Procedurale

Aktakuza PPS nr. 23/2010 e datës 13 Korrik 2010 dhe e ngritur në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, nga Prokurori i PSRK Suad Kuraja me 16 Korrik 2010 i ka akuzuar të Akuzuarit [redacted] dhe [redacted] me Krim te Organizuar në shkelje te Nenit 274, Paragrafi (3) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm në shkelje te Nenit 229, Paragrafi (4), Nën-paragrafi (1) si lexohet me Paragrafin (2) te KPK. Të Akuzuarit [redacted] dhe [redacted] jane akuzuar me Krim të Organizuar në shkelje të Nenit 274, Paragrafi (1) dhe Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm and ne shkelje të Nenit 229, Paragrafi (4), Nen-paragrafi (1) lexohet me Paragrafin (2) te KPK. Aktakuza është konfirmuar me 07 Shtator 2010.



## B. Kompetenca e Gjykatës

Sipas Nenit 23 Pika 1) i) të KPPK, Gjykatat e Qarkut janë kompetente të degjojnë rastet penale që involvojnë akuzat për të cilat ligji lejon shqiptimin e denimit penal prej se paku pesë vjet. Secili nga të katër të Akuzuarit janë akuzuar me veprat penale të Krimit të Organizuar dhe Blerje, Posedim, Shprëndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm. Shkelja e Krimit të Organizuar sipas Paragrafit (1) dhe Paragrafit (3) dënohet me denim minimal prej shtatë vjet.

Sipas Nenit 27 Paragrafi (1) të KPPK kompetenca territoriale është e duhur për Gjykatën në qarkun ku pretendohet se është kryer krimi. Aktakuza në këtë rast pretendon se të Akuzuarit kanë kryer veprat penale në shtepinë e banuar nga i Akuzuari që gjendet në Komunën e Mitrovicës, që shtrihet brenda Qarkut të Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës është organi kompetent Gjyqësor për të degjuar këtë procedurë penale.

Sipas Nenit 3.1 të Ligjit mbi Kompetencat, Selektimin dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it ("Ligji mbi Kompetencat"), Gjyqtarët e EULEX-it kanë jurisdiksion dhe kompetenca "mbi secilën lëndë që hetohet apo ndjeket penalisht nga PSRK." Prokurorët e PSRK e kanë hetuar dhe e kanë ndjekur penalisht këtë lëndë dhe Aktakuzën e ka parashtruar Prokurori i PSRK Suad Kuraja. Kjo lëndë është dëgjuar nga Gjyqtarët vendor të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës gjatë fazës së Procedurës Paraprake. Më 06 Shtator 2010, duke vepruar sipas kërkeses për Gjyqtarët e EULEX-it nga ana e Avokateve Mbrojtës Kole Ramaj dhe Adem Vokshi, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur të caktojë Gjyqtarët e EULEX-it për të monitoruar lëndën që është dëgjuar para Gjyqtarit vendor gjatë fazës para konfirmimit të aktakuzës. Aktakuza është konfirmuar më 07 Shtator 2010 nga ana e Gjyqtarit vendor Ali Kutillovi. Gjyqtarja e EULEX-it Christine Lindemann-Proetel i ka monitoruar procedurat. Me 27 Tetor 2010, duke vepruar sipas kërkesës së Avokatit Mbrojtës Kole Ramaj dhe PSRK dhe për shkak të pamundësisë së Gjyqtarëve Vendor për të mbajtur seancat e Gjykimit Kryesor në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka lëshuar një vendim për të caktuar lëndën Gjyqtarëve të EULEX-it në fazën e Shqyrtimit Kryesor. Prandaj, Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës janë kompetent për të gjykuar këtë lëndë penale.

Trupi Gjyqësor i përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjyqësor dhe Gjyqtarët e EULEX-it Caroline Charpentier dhe Jonathan Welford-Carroll si anëtar të Trupit Gjyqësor. Nuk ka pasur kundërshtime nga palët sa i përket përbërjes së Trupit Gjyqësor.

## C. Përmbledhja e Dëshmimeve të paraqitura

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

- (1) [REDACTED], oficer i PK – 08 Dhjetor 2010 dhe 11 Shkurt 2011
- (2) [REDACTED] – 09 Dhjetor 2010
- (3) [REDACTED] – 09 Dhjetor 2010



- (4) [REDACTED] – 01 Shkurt 2011
- (5) [REDACTED] – 10 Shkurt 2011
- (6) KP Officer [REDACTED] – 11 Shkurt 2011

Më 01 Shkurt 2011, procesverbali i Inspektimit të Vendit të Krimit mbajtur më 05 Janar 2011 është lexuar në procesverbal.

Më 01 Shkurt 2011, janë lexuar në procesverbal dokumentet në vijim:

- (1) Raporti PK i nënshkruar nga Oficerët [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] (02 Shkurt 2010)
- (2) Lista e PK e Gjërave të Konfiskuara nga [REDACTED] (03 Shkurt 2010)
- (3) Memorandumi i PK nga Oficeret [REDACTED] (05 Shkurt 2010)
- (4) Report i PK mbi Inspektimin e Vendit të Krimit (i nënshkruar nga Oficerja Arta Ferati me 04 Shkurt 2010)
- (5) Reporti Informativ i PK i nënshkruar nga Oficerët [REDACTED] (28 Maj 2010)
- (6) Urdhëri i PSRK ndaj IPKO për regjistrimin e numrave tel. (23 Mars 2010)
- (7) Urdhëri për regjistrimin e SMS-ëve të të dyshuarëve i lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake Ferit Osmani (08 Prill 2010)
- (8) Memo e PK për PSRK me kërkesë për lëshimin e urdhërit për telefonatat për numrin e telefonit [REDACTED] (24 Shkurt 2010)
- (9) Memorandum i PK nga oficeri [REDACTED] (12 Prill 2010) me regjistrimin e telefonatave të ofruara nga IPKO
- (10) Memorandum i PK nga oficerët [REDACTED] (23 Prill 2010) me regjistrimin e telefonatave të ofruara nga IPKO
- (11) Report i PK për PSRK nga Oficerët [REDACTED] (17 Qershor 2010)
- (12) Raporti i PK mbi Ekzaminimin Kriminal (15 Qershor 2010)
- (13) Raporti i PK i ekspertit Sokol Dedaj (24 Qershor 2010)
- (14) Foto albumi nga oficeri i PK Besim Osmani
- (15) Raporti për Drejtoratin për Krime të Organizuara nga Oficeri [REDACTED] (24 Shkurt 2010)
- (16) Raporti i Oficerit të PK nga [REDACTED] (05 Mars 2010)
- (17) Regjistri i SMS-ëve për/nga [REDACTED] (22 Prill 2010)
- (18) Aktgjykimi i Shkurorëzimit në lidhje me [REDACTED] dhe ish-bashkëshorten e tij
- (19) Kontrata banesore (01 Janar 2010)
- (20) Deklarata e [REDACTED] dhe [REDACTED] në lidhje me blerjen e veturës
- (21) Qertifikata e Lindjes së [REDACTED]
- (22) Regjistri i Ekzaminimit të Dëshmitarit [REDACTED] (24 Maj 2010)
- (23) Raporti i Oficerit të PK [REDACTED] në lidhje me kontrollimin e veturës (19 Shkurt 2010)

Më 11 Shkurt 2011, dokumentet në vijim janë lexuar në procesverbal:

- (24) Urdhëri i PSRK për Masat e Fshehta – Regjistrimi i Telefonatave dhe SMS-ëve të [REDACTED] dhe [REDACTED] (07 Prill 2010)
- (25) Urdhëri i PSRK për kthimin e artikujve [REDACTED] (22 Qershor 2010)



Më 22 Shkurt, dokumentet në vijim janë lexuar në procesverbal:

(26) Raporti Shtesë mbi Ekspertizën Forensike Laboratorike të PK (09 Shkurt 2011)

Gjatë seancave të shqyrtimit kryesor të dates 01, 02, 03 dhe 10 Shkurt 2011 te katër të akuzuarit kanë dhënë deklaratat e tyre dhe ata janë përgjigjur pyetjeve.

#### D. Vlerësimi i dëshmive të paraqitura

##### 1.

Më 08 Dhjetor 2010, [redacted] është deklaruar fajtor vetëm për veprën penale Blerje, Posedim, Shprërndarje dhe Shitje e Pa-autorizuar e Narkotikëve te Rrezikshëm. Në fakt, [redacted] ishte ai që ka shkuar vullnetarisht në polici dhe e ka pranuar involvimin e tij në drogë, si dhe implikimin e tre bashkë-akuzuarëve tjere. Kjo ka ndodhur më 02 Shkurt 2010, kur [redacted] është pajtuar me PK se do të kontaktonte policinë herën tjetër kur personat e involvuar në biznesin e drogës të binin drogë në shtëpinë e tij. Më 03 Shkurt 2010, [redacted] dhe [redacted] kanë shkuar në shtëpinë e [redacted] dhe [redacted] e ka thirrur policinë. Pastaj ishin arrestuar të tretw.

##### a. Deklaratat e mëparshme të [redacted]


Pas arrestimit të tij, [redacted] është intervistuar dy here nga Oficerët e PK dhe dy here nga Prokurorët e PSRK

Më 04 Shkurt 2010, në presence të Avokatit Mbrojtës, [redacted], [redacted] ka thënë PK:

- Më 01 Shkurt, [redacted] ka shkuar vullnetarisht në polici për të pranuar involvimin e tij në qështjen e drogës. Ai i ka informuar ata se pesë kg të marihuanës kanë qenë në shtëpinë e tij në atë kohë e cila ishte sjellë nga [redacted] nga gruaja e tij [redacted] dhe dy shqiptarëve të quajturë [redacted]
- Gjatë tre muajëve të mëparshëm, këta persona vazhdimisht kanë blerë marihuanë dhe atë e kanë perzier në shtëpinë e tij dhe [redacted] e kanë paguar për mbajtje të saj atje. Në përgjithësi, afro 500 kg të drogës janë dërguar në shtëpinë e tij e pastaj janë transportuar për në Serbi dhe Bosne gjatë kësaj periudhe. Shqiptarët e kanë transportuar drogën me Mercedes gjersa [redacted] dhe [redacted] kanë përdorur një Passat të gjelbërt. [redacted] e ka bërë përzjerjen e heroines duke e përdorur një site. [redacted] gjithashtu kishte dërguar një matëse digjitale për qëllime të matjes së drogës.
- Më 03 Shkurt 2010, rreth orës 17:30, [redacted] dhe [redacted] kanë dërguar drogë në shtëpi në dy qanta.

Më 22 Shkurt 2010, në presence të avokatit të tij mbrojtës, [redacted], [redacted] i ka thënë oficerit të PK:

- Tri ditë pasi që babai i tij, [redacted] ka shkuar jashtë shtetit rreth fundit të Shtatorit dhe fillimit të Tetorit 2009 [redacted] e ka bindur atë për të





filluar me biznesin ilegal të drogës. [redacted] do ti dorëzonte [redacted] 30-50 euro për mbajtje të drogës në shtëpinë e tij. Droga është dorëzuar në shtëpinë e [redacted] nga ana e dy Shqiptarëve të quajtur [redacted] dhe [redacted], [redacted] dhe [redacted]. [redacted] ka qenë "personi kryesor" në grup.

- [redacted] dhe [redacted] do të dorëzonin marihuanë dhe [redacted] ka qenë gjithnjë i pranishëm. [redacted] do të ngiste Jeep-in e tij para Shqiptarëve të cilët janë vozitur në Mercedes me targa regjistrimi të Shqiptërisë. Droga është mbajtur në bagazh të veturës. Kur janë parkuar në shtëpinë e [redacted] dhe [redacted] do të mbanin drogën brenda gjersa [redacted] nuk do të hynte brenda.
- [redacted] dhe [redacted] do të dorëzonin heroin dhe do të pregatitnin atë në shtëpinë e [redacted]. Ata nuk e kanë matur substancën. [redacted] ka perzier atë e pastaj që të dy e kanë paketuar atë. Kur ka arritur dërgesa e re e drogës [redacted] do të telefononte [redacted] dhe do ti thoshte atij "Pregatitu, sonte do të vi për të të marrë që të shkojmë për të luajtur futboll." Pastaj [redacted] do të takohej me [redacted], [redacted] dhe Shqiptarët në kafe barin Rus.

Me 12 Mars 2010, Prokurori i PSRK Ismet Ujkani e ka intervistuar [redacted] në presence të avokatit të tij mbrojtës [redacted]. [redacted] e ka invokuar të drejtën e tij për të mos folur.

Me 24 Prill 2010, Prokurori i PSRK Suad Kuraja e ka intervistuar [redacted] në presencë të Avokatit të tij mbrojtës [redacted] dhe [redacted] ka deklaruar me sa vijon:

- [redacted] ka propozuar që [redacted] ka filluar të mirret me drogë në fund të vitit 2009 kur babai i [redacted], [redacted] ishte jashtë shtetit.
- Herën e parë [redacted] i ka sjelle në shtëpi të [redacted], [redacted] dhe dy Shqiptar me emrat [redacted] dhe [redacted]. Para se të vinin në shtëpi [redacted] e ka telefonuar [redacted] dhe ka thënë "Pregatitu se ne do të shkojmë të luajme futboll" për ta alarmuar atë në lidhje me ardhjen. [redacted] dhe [redacted] kanë ardhur në shtëpi me Jeep të [redacted] gjersa Shqiptarët kanë qenë në Mercedes me targa të Shqipërisë. [redacted] e ka marrë drogen nga bagazhi i Mercedes, [redacted] e ka mbajtur një qese të vogël dhe të gjithë kanë hyrë në shtëpi, përveç [redacted] i cili është larguar me veturë pa hyrë fare brenda. Në qese kanë qenë afro 30 kg marihuana në paketime të mbeshtjellura me një ngjitese adezive. Të pesë personat i kanë nxjerre paketimet jashtë qeseve dhe ato i kanë ri-paketuar në paketime me të vogla për afro një orë. [redacted] dhe [redacted] i kanë numëruar paketimet. [redacted] e ka thirrur [redacted] dhe atij i ka thënë që të vije dhe ti marrë ato. Pas pesë minutave, [redacted] e ka parë [redacted] duke vozitur veturën në drejtim të shtëpisë me Jeep dhe [redacted] dhe [redacted] kanë hyrë në Mercedesin e tyre dhe ata e kanë percjellur [redacted] gjersa ai largohet. [redacted] dhe [redacted] e kanë perfunduar paketimin dhe [redacted] ka futur paketimet në qese. [redacted] e ka bërë një telefonatë [redacted] dhe ai ka folur në gjuhën Boshnjake. Ata i kanë lenë qeset në dhomë dhe [redacted] e ka mbyllur derën me dry. Ata kanë dalur jashtë dhe pas 7-10 minutave [redacted] ka arritur me Jeep të tij. [redacted] dhe [redacted] kanë ikur së bashku me [redacted] në Jeep-in e tij. [redacted] e ka paguar [redacted] 50 Euro.
- [redacted] ka qenë personi kryesor në operacionin e drogës. [redacted] e ka kontaktuar [redacted] dhe atë e ka informuar dhe [redacted] gjithnjë ka vepruar sipas udhëzimeve të [redacted] bashku [redacted] e ka informuar [redacted]



- ██████████ dhe ██████████ i ka thënë ██████████ se kur ██████████ u ishte nevojitur droga ██████████ ka thirrë personat nga Shqipëria dhe ai e ka porositur drogen. Droga është sjelle në shtëpinë e ██████████ në afro dhjetë raste dhe secilen herë ██████████ e ka paguar ██████████ 30-50 Euro.
- Droga është larguar nga shtëpia ██████████ nga persona të panjohur të cilët i ka udhëzuar ██████████. Këta persona kanë arritur me vetura të ndryshme dhe kanë hyrë në garzhden e shtëpisë së ██████████. ██████████ i ka sjelle në garazhde qeset e drogës nga dhoma e mbyllur me dry dhe atë e kanë vendosur në bagazh të veturës. Pastaj persona të panjohur kanë ikur me veturë dhe ██████████ e ka telefonuar ██████████ për të marrë atë dhe ██████████ nga shtëpia e ██████████ e ka informuar ██████████ se droga duhej të kalonte nga Serbia për në Bosne.
  - ██████████ ka sjelle heroin në shtëpinë e ██████████ në disa raste. ██████████ ka qenë bashkë me ██████████ në gati të gjitha këto raste. ██████████ ka vozitur një Passat ngjyre të gjelbert me targa të huaja regjistrimi.
  - Te total, afro 500 kg marihuana dhe heroine është sjelle në shtëpinë e ██████████ e bazon këte afersi në matjet e bera kur ██████████ dhe ██████████ e kanë peshuar drogen..
  - Në mbremjen e 03 Shkurt 2010, ██████████ e ka telefonuar ██████████ dhe atij i ka thënë "Pregatitu se pas 2-3 diteve unë do të vë për të luajtur futboll" Atë natë, ██████████ ka sjellë ██████████ dhe ██████████ në shtëpinë e ██████████ i cili me atë ka sjellë marihuane. Ata e kanë mbajtur atë në një dhomë të mbyllur me dry ku ka pasur pak marihuanë që ishte blerë me heret nga ██████████ dhe ██████████. Ata kanë shkuar poshtë shkalleve ku kanë qenë anëtarët tjerë të familjes. Në këte kohë, ██████████ e ka telefonuar policinë siq ishin pajtuar me heret.
  - ██████████ kishte vendosur për të shkuar në polici dhe për të pranuar sepse ai ndihej se po u fundosej me shumë në qeshtjen e drogës dhe ai donte të dilte nga ky biznes. Femija i tij i parë kishte lindur një javë pas arrestimit të ██████████


Gjersa mund të këte disa diferenca procesverbali në këto deklarata ato në përgjithësi janë shumë konsistente dhe të detajizuara.

**b. Deshmia e ██████████**

Gjatë Gjykimit Kryesor me 03 dhe 10 Shkurt 2011, kur ██████████ ka dhënë deshmi para Gjykatës dhe kur është përgjigjur pyetjeve ai ka dhënë deklarime të ndryshme të fakteve. ██████████ tani pretendon se 1) ██████████ nuk ka qenë i involvuar fare në drogë 2) ka qenë vetëm një rast kur droga ishte sjelle në shtëpinë e tij 3) Oficeret e PK ██████████ e kanë detyruar atë të japë deklarata të rrejshme në intervistat e tij të mëparshme.


Në detale ██████████ ka deklaruar se:

- ██████████ nuk ka qenë i involvuar me drogë. ██████████ nuk ka pasur asgjë me ██████████ përveq telefonatës së ██████████ duke e pyetur për babain e tij apo duke dëshiruar të flasë me vellaun e tij ██████████
- Edhe pse ██████████ nuk i kujtohej se si e kishte takuar ██████████ për herë të parë atij i kujtohej se atë e kishte parë në një kafeteri një herë apo dy herë dhe duke luajtur me "gur". Ai e kishte njohur ██████████ si personin që gjithnjë kishte qenë së bashku me ██████████



- Pasi qe babai i tij [redacted] e kishte lëshuar Kosovën për të shkuar jashtë vendit, [redacted] e ka parë [redacted] dhe [redacted] së bashku me dy persona te panjohur dhe të gjithë së bashku kishin pirë kafe. Dy personat ishin prezantuar si [redacted] dhe [redacted] dhe ata kane thënë se ishin nga Shqipëria. Ata e kane pyetur atë se a ishte i interesuar të gjente pune dhe i kane ofruar atij para në shkembim që ata te linin disa gjëra në shtëpine e tij. Ata i kane thene atij se do te linin "bari" dhe ai kishte thënë se ata mund të vendosnin ate në një dhomë në katin e dytë në shtëpine e familjes së tij. Ështe pajtuar se [redacted] dhe [redacted] lo të telefononin [redacted] pas dy apo tri diteve per te sjelle bari dhe atij do ti sillnin nje shumë të parave. [redacted] mendoi që "bari" ishte caj, jo drogë, dhe ai nuk dyshonte lidhur me të. Ata nuk ranë dakort se sa do ta paguanin [redacted], por [redacted] dhe [redacted] thanë atij, "ti do të bësh para nga ky pazar".
- Dy apo tri ditë më vonë, njëri nga shqiptarët e thirri [redacted] dhe e ftoi për kafe. Ndërsa pinin kafe, [redacted] dhe [redacted] informuan atë se ata e kishin sjellë barin dhe e pyetën përsëri nëse mundej ta ruante në shtëpinë e tij. Ata e udhëzuan atë, po ashtu, që "ti nuk duhet t'i tregosh askujt". [redacted] pranoi dhe ata vozitën deri tek shtëpia e tij në makinën që ishte e shqiptarëve. Ata nxorrën dy apo tri cantat të mëdha të zeza nga bagazhi i makinës, të cilat ishin të mbushura me bar. [redacted] i udhëhoqi ata në shtëpi dhe ata i vendosën cantat në një dhomë në katin e dytë. [redacted] e mbylli derën me celës dhe ata u kthyen që të gjithë bashkë në qytet me qëllim që të blinin një peshore dixhitale, qese, letër metalike dhe doreza. Shqiptarët kërkuan gjithashtu edhe thika, të cilat ua dha [redacted]. Në të njëjtën natë, ata u kthyen në dhomë, me qëllim që të "paketonin cajt". Ata e peshuan atë dhe e paketuan në qese të mbështjella me letër metalike. Pastaj ata e paguan [redacted] 50 euro dhe i thanë atij se ose ata ose [redacted] do t'i merrte ato pas disa ditësh. Ata u larguan dhe [redacted] e mbylli dhomën me celës.
- Cantat e "cajit" mbetën në dhomën e mbyllur me celës, për afërsisht katër muaj, gjatë së cilës kohë [redacted] nuk pati kontakte me [redacted] [redacted] apo [redacted].
- Më 2 shkurt 2010, [redacted] shkoi në polici dhe bisedoi me oficerin e policisë së Policisë së Kosovës, [redacted]. Ai e informoi oficerin [redacted] lidhur me cantat e drogës në shtëpinë e tij.
- [redacted] erdhi në shtëpinë e tij me [redacted] në mbrëmjen e datës 3 shkurt 2010, me qëllim që të merrte cantat me drogë. [redacted] nuk kishte patur asnjë kontakt me ta, qëkur kishin pirë kafe bashkë, përpara se [redacted] dhe [redacted] të sillnin cantat në shtëpi. [redacted] mori në telefon policinë, ashtu sic kishin rënë dakort më parë, dhe policia erdhi dhe arrestoi [redacted] dhe [redacted] (atë natë).
- Nuk ka pasur asnjëherë 500kg drogë në shtëpinë e tij, por oficerët e PK [redacted] e detyruan atë të thoshte kështu në deklaratat e tij të mësipërme.

Trupi gjykues konstatoi se të dhënat e ofruara nga [redacted] në deklaratat e tij të mëparshme në polici dhe prokurori ishin përshkrimi i plotë dhe i vërtetë, dhe se versioni i ri të cilin e paraqiti në gjykatë gjatë dëshmisë, nuk ishte i besueshëm.



Informata e parë e [redacted] që [redacted] nuk ishte i përfshirë me drogën.

Lidhur me informatën e tij të parë – që [redacted] nuk ishte fare i përfshirë me drogën, dhe se [redacted] kishte kontakt mjaft të kufizuar me të gjatë muajve në fjalë – nuk është as e besueshme dhe as mbështetet nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, apo edhe nga provat e dokumentuara në dosjen e lëndës.

Oficeri i PK, [redacted], dëshmoi se [redacted] në fillim përmendi emrin [redacted] pasi e kishte dhënë një deklaratë në polici më datën 4 shkurt 2010. Kjo nuk gjendej në procesverbalin e Marrjes në Pyetje të të Dyshuarit, sepse kjo gjë u deklarua pas intervista kishte përfunduar dhe [redacted] nuk donte ta rihapte intervistën dhe të bënte deklaratat të tjera, pasi kishte filluar të shqetësohej për sigurinë e tij.

Prandaj, PK e njoftoi gojarisht Prokurorin Publik, lidhur me këtë informatë të re.<sup>1</sup>

Kjo është mbështetur nga dëshmitarët [redacted] dhe [redacted]. Oficeri i PK, [redacted] deklaroi që [redacted] e përmendi së pari emrin [redacted] pasi ata e kishin përfunduar intervistën formale të të dyshuarit. Një oficer tjetër i PK që morri pjesë e kishte ditur se [redacted] në fakt ishte [redacted] dhe PK e informoi prokurorin gojarisht lidhur me këtë informatë të re.<sup>2</sup> [redacted] dëshmoi se ai ishte i pranishëm në intervistën e 4 shkurti si [redacted]. Atij iu kujtua se pasi intervista kishte përfunduar, [redacted] bisedoi me një oficer të PK që quhej [redacted], megjithatë [redacted] nuk e dëgjoi përmbajtjen e bisedës së tyre.<sup>3</sup> Në bazë të procesverbalit të intervistës së të dyshuarit, oficeri PK, [redacted] ishte i pranishëm.

Ndërkohë që për arsyen e dhënë nga oficeri i PK, Procesverbali i Intervistës së të Dyshuarit, i datës 4 shkurt 2010 nuk e përmend as [redacted] as [redacted], provat e tjera të dokumentuara i mbështesin deklaratat e oficerëve të PK dhe [redacted]. Më 22 shkurt 2010, PSRK lëshoi një kërkesë për Qendrën e Parburgimit të Dubravës, që oficerët e PK ta marrin në pyetje [redacted] përsëri. Një Raport Policie i hartuar nga oficeri [redacted], i datës 24 shkurt 2010 deklaron që edhe pasi [redacted] intervistua më 4 shkurt, ai tha që [redacted] ishte i përfshirë me drogën dhe se kjo ishte arsyeja që policia shkoi për të marrë në pyetje [redacted] për herë të dytë, më 22 shkurt 2010, në Qendrën e Parburgimit në Dubravë. Përpara gjykatës, oficeri [redacted] konfirmoi se arsyeja për kërkesën në Dubravë, ishte për të marrë të dhëna të tjera nga [redacted] lidhur me [redacted].<sup>4</sup>


Përveç kësaj, ndërkohë që nuk ka asnjë provë të tregojë se [redacted] është detyruar nga oficerët e PK të japë deklaratat të rreme kundër [redacted] (e cila diskutohet në detaje më poshtë), me të vërtetë ka prova që [redacted] është ndikuar nga djali i [redacted] që ta ndryshojë versionin e tij dhe të verë në vend figurën (emrin) e [redacted]. Sipas Raportit të PK për prokurorin e ZPSRK, Suad Kuraja, që mban datën 17 qershor 2010, oficerët [redacted] shkuan të bisedonin me [redacted] dhe u informuan se atij i kishte shkuar për vizitë në shtëpinë e tij [redacted].

<sup>1</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 dhjetor 2010, fq. 16-17, 19-20; Shih gjithashtu Procesverbalin e Intervistës së të Dyshuarit, Seksioni Rajonal i PK për Hetimin e Narkotikëve, 4 shkurt 2010.

<sup>2</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 11 shkurt 2011, fq. 13.

<sup>3</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 shkurt 2011, fq. 15.

<sup>4</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 dhjetor 2010, fq. 21.



(djali i të akuzuarit [REDAKTUAR], dhe një person tjetër në praninë e avokatit të tij mbrojtës në atë kohë, [REDAKTUAR] dhe babai i tij, [REDAKTUAR] thanë PK se [REDAKTUAR] dhe personi tjetër "i sugjeruan [REDAKTUAR] që ta ndryshonte deklaratën e tij që kishte dhënë më herët" lidhur me inkriminimin e [REDAKTUAR]. Më 10 shkurt 2011, [REDAKTUAR] u thirr që të dëshmonte përpara gjykatës. Po ashtu, [REDAKTUAR] iu përgjigj pyetjeve specifike lidhur me takimin që ndodhi në shtëpinë e [REDAKTUAR] dëshmoi se biseda gjatë takimit kishte të bënte me përgjegjësinë e [REDAKTUAR] deklaroi se babai i tij, [REDAKTUAR] ishte i pafajshëm, [REDAKTUAR] mësoi për herë të parë se ishte [REDAKTUAR] ai që e kishte raportuar rastin në polici, dhe se palët diskutuan që [REDAKTUAR] ndryshonte dëshminë e tij. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] më pas, kërkuan nga [REDAKTUAR] të dorëzonte një kërkesë në PSRK, që [REDAKTUAR] të merrej përsëri në pyetje për këtë qëllim. Avokati mbrojtës [REDAKTUAR] e dorëzoi këtë kërkesë në PSRK më datën 16 qershor 2010<sup>6</sup>, sidoqoft kërkesa është refuzuar.

Për më tepër, shpjegimi i [REDAKTUAR] se përse në fillim ai e inkriminoi [REDAKTUAR] nuk është i besueshëm. Gjatë dëshmisë së tij, [REDAKTUAR] deklaroi se e kishte inkriminuar më parë [REDAKTUAR] sepse ai i kishte kërkuar [REDAKTUAR] të merrte avokatin Mahmut Halimi si avokatin e tij mbrojtës, dhe [REDAKTUAR] nuk ishte në gjendje ta bënte këtë.<sup>7</sup> Gjykata nuk e sheh këtë shpjegim si të besueshëm. Që të dy, si [REDAKTUAR] ashtu dhe [REDAKTUAR] dëshmuuan se [REDAKTUAR] kishte qenë mik i familjes prej një kohe të gjatë dhe se motra e [REDAKTUAR] ishte fqinja e [REDAKTUAR].<sup>8</sup> [REDAKTUAR] dëshmoi gjithashtu se ai e njohte mjaft mirë [REDAKTUAR]. Duke pasur parasysh lidhjet e forta familjare që ekzistojnë mes miqve të familjes në Kosovë, dhe duke pasur parasysh provën e ushtrimit të presionit ndaj [REDAKTUAR] për ta ndryshuar versionin e tij, është thjeshtë e pabesueshme që [REDAKTUAR] do të motivohej për të inkriminuar një mik kohëgjatë të familjes për një aludim të një veprë të rëndë penale, thjeshtë duke u nisur nga fakti se ky shok nuk kishte mundësi të ndërmytesonte marrjen e Mahmut Halimit si avokatin e tij mbrojtës.

Gjykata vëren, po ashtu, se ka prova që përcaktojnë se ekziston një numër i konsiderueshëm telefonatash mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] dëshmoi se ai nuk kishte kurrfarë marrëveshjeje me [REDAKTUAR] dhe se [REDAKTUAR] do ta merrte në telefon ndonjëherë, por vetëm për ta pyetur për babanë e tij, [REDAKTUAR] apo për të folur me vëllain e tij, [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, të dhënat lidhur me matjen e telefonatave mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] tregojnë se ka pasur me të vërtetë një kontakt mjaft të madh mes dy të akuzuarve gjatë periudhës kritike kohore. Ka pasur një numër të përgjithshëm prej 62 telefonatash mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], nga telefonat e tyre celularë në peirudhën dy mujore përpara arrestimit të [REDAKTUAR] kohë kjo gjatë së cilës [REDAKTUAR] ka qenë jashtë Kosovës.<sup>10</sup> Ndërkohë që kjo nuk e dokumenton sjelljen

<sup>5</sup> Avokati mbrojtës [REDAKTUAR] u caktua sipas detyrës zyrtare dhe e përfaqësoi [REDAKTUAR] që kur u arrestua e deri në seancën e Konfirmimit, kur u caktua sipas detyrës zyrtare avokati Xhelal Hasani.


<sup>6</sup> Parashtrësë e datës 16 qershor 2010, Dosja e prokurorit III-1, f. 221 (në gj. angleze).

<sup>7</sup> Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 3 shkurt 2011, fq. 17.

<sup>8</sup> Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 Dhjetor 2010, f. 7-8 (dëshmia e [REDAKTUAR]); Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 03 shkurt 2011, f. 30 (dëshmia e [REDAKTUAR]).

<sup>9</sup> Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 01 shkurt 2011, f. 18.

<sup>10</sup> Rexhistrimi i telefonatave nga IPKO për telefonatat e bëra dhe të pranuar për numrin [REDAKTUAR] (që i përkiste [REDAKTUAR]) nga data 8 dhjetor 2009 deri më 3 shkurt 2010.



kriminale, e mohon dëshminë e [redacted] lidhur me sasinë e kufizuar të kontaktit që ai kishte pasur me [redacted].

*Pohimi i dytë i ri [redacted] lidhur me sasinë e përfshirë të drogës*

Lidhur me pohimit të dytë të ri në dëshminë e [redacted] – që kishte pasur vetëm një rast kur droga ishte sjellë në shtëpinë e tij – gjykata e konsideron këtë informatë, po ashtu, jo të besueshme.

[redacted] vazhdimisht ka deklaruar në marrjet e mëparshme në pyetje dhe në dëshminë e tij se hera e parë që droga ishte sjellë në shtëpinë e tij ishte në fund të shtatorit ose në fillim të tetorit të vitit 2009, kur babai i tij u largua nga Kosova për në Zvicër. Është përcaktuar nga dëshmitë dhe provat e dokumentuara se [redacted] shkoi në polici për të raportuar drogën, afërsisht katër muaj më vonë, më 2 shkurt 2010.

Që të pranohet informata e re e [redacted] gjykata do të duhet të besonte që dy shqiptarët, të cilët [redacted] aspo i kishte takuar, sollën mbi 26 kg marihuanë në shtëpinë e tij dhe e lanë atë për katër muaj, pa pasur ndonjë kontakt me [redacted] dhe këtyre shqiptarëve apo bashkë-të akuzuarve. Pastaj, më 3 shkurt 2010, pa ndonjë njoftim paraprak, [redacted] dhe [redacted], të cilët as e kuptojnë dhe as e flasin gjuhën shqipe, erdnën në shtëpinë e tij papritur me qëllim që të merrnin drogën në fjalë. Thjeshtë nuk është e besueshme që personat e përfshirë në tregtinë e drogës do ta lënin këtë sasi marihuane në shtëpinë e një personi krejtësisht të panjohur për disa muaj me radhë.

Sipas deklaratave të mëparshme të [redacted] kishte pasur disa raste kur droga ishte sjellë në shtëpinë e tij dhe ishte marrë prej shtëpisë së tij, dhe se ai vlerësonte se sasia e përgjithshme e drogës shkonte deri në afërsisht 500 kg [redacted] dha një përshkrim të detajuar të mënyrës se si droga merrej nga shtëpia e tij nga persona të panjohur, të cilët do të vinin me makinë deri në garazhin e tij dhe do ta vendosnin drogën në bagazhin e makinës së tyre.


Për më tepër, meqë droga e vetme që u gjend dhe u konfiskua nga shtëpia e [redacted] më 3 shkurt 2010 ishte marihuanë, dëshmia e re e [redacted] iuk shpjegon se si gjurmët e heroinës u gjendën në peshoren dixhitale, sitën plastike dhe kullonjësen metalike, të cilat u konfiskuan gjithashtu nga dhoma ku mbahej droga.<sup>11</sup> Provat e kriminalistikës provojnë se kishte pasur drogë – vecanërisht heroinë – që ishte sjellë në shtëpinë e [redacted] të paktën edhe një rast tjetër.

Prandaj, trupi gjykues konstaton se droga ishte sjellë në shtëpinë e [redacted] në më shumë se një rast. Megjithatë, as numri actual i herëve apo sasia e përgjithshme e drogës, që ka hyrë e ka dalë në mënyrë transit në shtëpi, nuk mund të përcaktohej.

*Pohimi i tretë i ri i [redacted] që policia ka bërë presion në të të jepte deklaratë të rreme*

Së fundmi, lidhur me pohimin e tretë të ri të [redacted] se ai ishte detyruar të bënte deklaratatë të rreme nga policia – që të dy oficerët e PK janë marrë në pyetje në mënyrë rigorozë nga gjykata lidhur me faktin, [redacted] ndonjëri prej tyre kishte ushtruar ndonjë presion mbi [redacted] janë marrë në pyetje nga PK, ose që të

<sup>11</sup> Laboratori i Forenzikës së PK, Raporti i Shkencës i Ekspertizës, 9 shkurt 2011.



inkriminohej ndonjë person i caktuar, ose që të ekzagjerohej sasia e drogës, dhe të gjitha këto pyetje janë përgjigjur në mënyrë negative.<sup>12</sup> Gjykata konstatoi se oficerët e PK ishin të besueshëm. Përveç kësaj, [redacted] është përfaqësuar nga avokati mbrojtës [redacted] në të gjitha intervistat paraprake para Policisë dhe Prokurorisë. [redacted] ka konfirmuar në dëshminë e tij se ai ishte prezent në të gjitha herat dhe se [redacted] nuk kishte qenë nën kurrëfarë presioni.<sup>13</sup> Gjykata është e bindur se Zyrtarët e PK nuk kishin ushtruar ndonjë presion apo ndikim mbi [redacted], që ai të bënte ndonjë deklaratë gjatë marrjeve në pyetje nga policia.

### c. Përfundimet lidhur me deklaratat e [redacted]

Për të gjitha arsyet e mësipërme, gjykata konsideron se deklaratat e mëparshme që ka dhënë [redacted] më 4 dhe 22 shkurt 2010 dhe më 24 prill 2010, përfaqësojnë një version të saktë të ngjarjeve. Deklaratat e dhëna drejtëpërdrejtë në gjykatë do të konsiderohen si fakte, vetëm deri sa ato mbështesin deklaratat e mëparshme. Pohimet e reja të dhëna nga [redacted] në dëshminë e tij, nuk do të merren në konsideratë.

### 2. Provat që mbështesin Deklaratat e [redacted]

Ekzistenca dhe struktura e një grupi të organizuar kriminal që posedonte, transportonte dhe shpërndante narkotikë për qëllime përfitimi, është shpjeguar në detaje nga [redacted] në deklaratat e tij të mëparshme dhe deklaratën në gjykatë. Ai i siguroi Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë emrat e anëtarëve të këtij grupi dhe përshkroi rolin e secilit anëtar, procesin sipas të cilit narkotikët dërgoheshin transit përmes shtëpisë së tij në Mitrovicë, si edhe qëllimin e përgjithshëm të grupit.

Deklaratat e [redacted], mbështeten edhe nga të dhënat e matjes së telefonatave, narkotikët dhe pajisjet e tyre, të cilat u konfiskuan nga shtëpia e [redacted] më 3 shkurt 2010, dhe nga ekspertiza kriminalistike.

Të dhënat lidhur me matjet tregojnë se ka pasur kontakt të përhershëm telefonik mes [redacted] dhe [redacted], dhe midis [redacted] dhe [redacted] që nga dhjetori 2009 e deri kur ata u arrestuan, më 3 shkurt 2010. [redacted] ishte lidhja mes [redacted], [redacted] dhe anëtarëve të panjohur të grupit nga Shqipëria, dhe secili anëtar i grupit i mbante kontaktet telefonike me [redacted] dhe jo me njëri-tjetrin. Numri i madh i telefonatave – 127 telefonata mes [redacted] dhe [redacted] dhe 62 telefonata mes [redacted] dhe [redacted], brenda një periudhe prej 52 ditësh – nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme si kontakt i rastësishëm apo si këshilla për baste.

Përveç kësaj, na del një prototip i telefonatave gjatë ditëve të caktuara, të cilat sigurojnë mbështetje për dëshmitë e [redacted] që [redacted] organizonte shpërndarjen e drogës në shtëpinë e tij, kontaktonte [redacted] të bënte përpunimin e drogës atje, dhe koordinonte marrjen e drogës. Për shembull, më 23 dhjetor 2009 janë bërë telefonatat e mëposhtme në kohët e specifikuara:

11:06:49 [redacted] merr në telefon [redacted]  
11:07:24 [redacted] merr në telefon [redacted]  
11:13:28 [redacted] merr në telefon [redacted]

<sup>12</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 11 shkurt 2011, fq. 2, 4, 7 (dëshmia e [redacted]), 10-12 (dëshmia e [redacted]).

<sup>13</sup> Procesverbal nga shqyrtimi kryesor gjyqësor i datës 10 Shkurt 2011, f. 10-11.



11:15:21 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 11:26:24 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 12:48:35 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 13:25:06 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:31:33 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:40:13 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:42:24 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:42:34 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:49:27 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 15:52:52 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 16:32:46 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 17:55:27 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 17:55:28 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 18:12:16 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 18:40:39 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 18:49:02 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 19:46:49 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 19:47:21 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 22:02:22 [redacted] merr në telefon [redacted]  
 22:03:23 [redacted] merr në telefon [redacted]

Është e qartë nga koha e bërjes së telefonatave që atë ditë, [redacted] po koordinonte dicka mes [redacted] dhe [redacted]. Ky prototip mund të shihet gjithashtu edhe në ditë të tjera, kur [redacted] do të pranonte telefonata nga njëri anëtar i grupit dhe pastaj menjëherë do të kontaktonte një anëtar tjetër të grupit. Për shembull, më 22 dhjetor 2009 [redacted] mori në telefon [redacted] në orën 21:52:50 dhe pastaj [redacted] mori në telefon [redacted] në orën 21:56:26; më 14 janar 2010 [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 20:02:59 dhe pastaj [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 20:04:36; më 15 janar 2010 [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 08:19:03 dhe pastaj [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 08:19:50, më vonë në të njëjtin mëngjes, [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 08:40:32 dhe pastaj [redacted] merr në telefon [redacted] në orën 08:45:43.

Për më tepër, 26.449 kg kanabis (marihuane) dhe 4.342 kg substancë pluhuri me ngjyrë kafe të lehtë u konfiskuan nga dhoma në katin e dytë të shtëpisë.<sup>14</sup> Substanca pluhur u konstatua të ishte një përzierje e Acetaminofenit (Paracetamolit) dhe Kafeinës, e cila njihet që përdoret për t'u përzier me heroinën dhe opiatet.<sup>15</sup> Policia konfiskoi po ashtu edhe një peshore dixhitale, dy thika, një pirun zgarë, një palë gërshtë, një kacavidë, një sitë plastike dhe një kullonjëse metalike, nga e njëjta dhomë. Gjurmë marihuana që përmbanin THC u gjetën tek peshorja dixhitale, thikat, piruni, gërshtëra dhe kacavida, ndërkohë që gjurmë heroine u gjendën tek sita dhe tek kullonjësja.<sup>16</sup>

### 3. [redacted]

Më 22 shkurt 2010, [redacted] mor në pyetje nga oficerët e PK, [redacted] dhe përdori të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje.

<sup>14</sup> Raporti i Ekzaminimit Penal të PK, 15 qershor 2010.

<sup>15</sup> Raporti i Ekzaminimit Penal të PK, 15 qershor 2010.

<sup>16</sup> Raporti Shtesë i Ekspertizës së Laboratorit Kriminolistik të PK, 9 shkurt 2011





Megjithatë, më 13 prill 2010, në praninë e avokatit të tij mbrojtës, Mahmut Halimi, [redacted] deklaroi si më poshtë vijon përpara Prokurorit Publik të ZPSRK:

- Ai e kishte njohur [redacted] prej 3-4 vjetësh, pasi e kishte takuar atë në Tuzla, Bosnjë dhe Hercegovinë. [redacted] arriti në Kosovë me [redacted] pesë apo gjashtë muaj përpara arrestimit të tij, sepse ai po largohej nga gruaja e parë e tij. [redacted] e vizitoi [redacted] dy herë në apartamentin e tij në Prishtinë; herën e parë me djalin e tij për të pirë kafe dhe herën e dytë në janar 2010 me [redacted] për të diskutuar marrjen e një vize kroate për [redacted]. Ai e takonte shpesh [redacted] dhe [redacted] me qëllim që të luanin letra dhe të vinin baste, por e telefononte atë "rrallë" për të biseduar me [redacted].
- [redacted] nuk kishte kontakte personale apo me anë të telefonit me [redacted] dhe nuk kishte qenë kurrë në shtëpinë e [redacted].
- [redacted] nuk kishte kontakte personale apo me anë të telefonit me ndonjë person në Shqipëri.
- [redacted] kishte vetëm një telefon, me numrin [redacted].
- Më 3 shkurt 2010, [redacted] ishte tek restoranti "Tifania" kur e mori në telefon [redacted] dhe [redacted] atëherë erdhën tek restoranti "Tifania". [redacted] insistoi që [redacted] t'i conte ata tek shtëpia e [redacted] për të biseduar vizën kroate dhe që ai t'i conte ata atje me makinën e tij të re. [redacted] i la ata 50 metra larg shtëpisë dhe nuk doli nga makina apo të hynte në shtëpinë e [redacted].
- Më 5 ose 6 shkurt 2010, [redacted] e takoi [redacted] në kafenenë "[redacted]" dhe e informoi atë se [redacted] ishte arrestuar dhe se [redacted] ishte zënë me drogë në shtëpinë e tij. Ai i kërkoi [redacted] të merrte [redacted] si avokat mbrojtës për [redacted]. [redacted] nuk e ndihmoi [redacted] dhe i tha atij të mos e merrte më kurrë në telefon. Kjo bisedë ndodhi në sy të [redacted].

Më 1 shkurt 2011, [redacted] dëshmoi përpara Gjykatës duke dhënë një deklaratë të shkurtër dhe duke iu përgjigjur pyetjeve. Me pak fjalë ai deklaroi se:

- Numri [redacted] i përket [redacted] dhe jo [redacted].
- Gjatë periudhës tetor 2009 deri në shkurt 2010, ai kishte folur në telefon me [redacted] një ose dy herë në janar 2010. Përndryshe, ai kishte folur në telefon vetëm me vëllain e [redacted], [redacted], apo me [redacted]. Ai kishte pasur kontakte personale me [redacted] vetëm kur e mori me makinën e tij dikur në dhjetor 2009.
- Pavarësisht se ai pranoi të kishte pasur edhe numra të tjerë telefoni në të shkuarën, ai mund të kujtonte vetëm numrin [redacted].
- [redacted] kishte biseduar rregullisht me persona në Shqipëri që në vitin 1999.



dhjetor 2009, ka pasur 31 telefonata mes [redacted] dhe [redacted].<sup>21</sup> Kjo e kundërshton drejtëpërdrejtë deklaratën e mëparshme të [redacted] se ai nuk kishte pasur kontakte me [redacted], dhe dëshminë e tij dhënë përpara gjykatës se ai kishte folur me [redacted] në telefon vetëm një ose dy herë. Kur është pyetur më në detje lidhur me këto telefonata, [redacted] dëshmoi se ai kishte marrë në telefon [redacted] dhe [redacted] dhe se numri i telefonit i përkiste [redacted].<sup>22</sup> Megjithatë, u përcaktua se gjatë asaj periudhe (deri më 15 janar 2010), [redacted] ka qenë jashtë Kosovës, në Zvicër.<sup>23</sup>

Të dhënat telefonike tregojnë po ashtu se gjatë periudhës 13 dhjetor 2009 deri më 3 shkurt 2010 (data kur është arrestuar edhe [redacted] ka pasur 127 telefonata mes [redacted] dhe [redacted].<sup>24</sup> Kjo e kundërshton në mënyrë të drejtëpërdrejtë deklaratën e mëparshme të [redacted] që ai "rrallë" kishte pasur biseda telefonike me [redacted]. Kur është përballur gjatë dëshmisë së tij me këtë paqëndrueshmëri dhe të dhënat telefonike, shpjegimet e [redacted] kanë qenë jo të kënaqshme. [redacted] është marrë në pyetje në mënyrë intensive nga Gjyqtari Jonathan Welford-Carroll lidhur me telefonatat mes tij dhe [redacted] gjatë periudhës dhjetor 2009 deri në janar 2010.<sup>25</sup> [redacted] deklaroi se ai kishte folur me [redacted] në telefon gjatë kësaj periudhe vetëm për bastet dhe se ata "normalishte e bënin këtë pasdite".<sup>26</sup> Megjithatë, të dhënat e matjeve të IPKO-s tregojnë se ka pasur telefonata gjatë gjithë kohës, ditën apo natën, duke përfshirë edhe kohën sic është 08:19 më 15 janar 2010 dhe madje edhe vonë, sic është ora 01:39 më 16 dhjetor 2009 dhe ora 01:44 më 23 dhjetor 2009.<sup>27</sup>

Gjykata vë re gjithashtu mospajtim në deklaratat e [redacted] nëse ai kishte bërë telefonata ndërkombëtare me një numër në Shqipëri. Gjatë intervistës së tij me Prokurorin, [redacted] deklaroi se ai nuk kishte kontakte personale apo telefonike me ndonjë person në Shqipëri. Gjatë dëshmisë së tij, ai deklaroi të kundërtën – se ai mbante kontakte të rregullta telefonike me persona që jetonin në Shqipëri. Kur është pyetur lidhur me këto telefonata, [redacted] deklaroi se gjatë dëshmisë së tij tek prokurori atij nuk i kujtohej të kishte marrë në telefon rregullisht Shqipërinë<sup>28</sup>; se numri që kishte marrë në telefon ishte i shokëve të tij, [redacted] (pavarësisht se nuk i kujtohej numri i telefonit)<sup>29</sup>; dhe se ai i merrte në telefon shokët e tij në Shqipëri vetëm gjatë pushimeve dhe ditëlindjeve.<sup>30</sup> Pavarësisht nga kjo, të dhënat telefonike tregojnë se [redacted] kishte bërë dhe kishte marrë një numër të përgjithshëm prej 63 telefonatash nga numra të ndryshëm në Shqipëri gjatë periudhës 14 dhjetor 2009 e deri më 3 shkurt 2010. Për më tepër, dëshmitarja [redacted] dëshmoi se familja

<sup>21</sup> Matjet telefonike nga IPKO për telefonatat e bëra dhe të pranuar nga numri i telefonit celular [redacted] (që i përket [redacted]) nga 8 dhjetor 2009 deri më 3 shkurt 2010.

<sup>22</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 2 shkurt 2011, fq. 8.

<sup>23</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 9 dhjetor 2011, fq. 7 (dëshmia e [redacted]); Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 3 shkurt 2011, fq. 19 (dëshmia e [redacted]); Raporti i Stacionit të Policisë Kufitare lidhur me deportimit e [redacted] nga Zvicra në Kosovë, që mban datën 15 janar 2010, në orën 15:20.

<sup>24</sup> Matjet telefonike të IPKO-s për telefonatat e bëra dhe të pranuar në numrin celular [redacted] (që i përket [redacted]) nga 13 dhjetori 2009 deri më 3 shkurt 2010.

<sup>25</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 2 shkurt 2011, fq. 19-21.

<sup>26</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 2 shkurt 2011, fq. 19.


<sup>27</sup> Matjet telefonike të IPKO-s për telefonatat e bëra dhe të pranuar në numrin celular [redacted]

(që i përket [redacted])

<sup>28</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 2 shkurt 2011, fq. 10.

<sup>29</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 1 shkurt 2011, fq. 20.

<sup>30</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 2 shkurt 2011, fq. 11.



me [redacted] në restorantin Tiffany. [redacted] ka kërkuar [redacted] që të shkojë në shtëpinë e [redacted] për të biseduar lidhur me vizën. Ata kanë shkuar në makinën e [redacted] pas kërkesës së [redacted] dhe kanë lënë makinën e tyre të parkuar në Tiffany. Ata kanë arritur në shtëpinë e [redacted] rreth orës 17:40 dhe [redacted] i ka zbritur [redacted] dhe [redacted] në rrugë dhe është larguar me makinë.

- Brenda në shtëpinë e [redacted], [redacted] ka folur me [redacted] lidhur me vizën. Pastaj, [redacted] ka pyetur [redacted] nëse ai ishte i interesuar në drogë. [redacted] është përgjigjur jo dhe pastaj [redacted] ka pyetur nëse ai njihte dikë në Bosnie që ishte i interesuar në drogë. Përsëri [redacted] tha jo dhe pastaj vendosi të largohej. Ai thirri një taksi por policia arriti dhe e arrestoi atë përpara që ata të mund të largoheshin.


Gjykata nuk e gjen deklaratën e [redacted] të besueshme për të njëjtat arsye për të cilat nuk besoi spjegimin e [redacted] se numri i madh i thirrjeve telefonike mes tij dhe [redacted] kishte të bëjë me biseda lidhur me bastore. [redacted] retendon se thirrjet e shumta telefonike mes tij dhe [redacted] kishin të bënin me bixhoz. Dhe kjo thjesht nuk është realiste nëse Gjykata pranon dëshminë e vetë [redacted] se ai ka luajtur bixhoz bashkë me [redacted] pothuajse çdo ditë, prej orës 13:00 deri natën vonë. Nëse këta të dy ishin së bashku duke luajtur bixhoz në bastore gjatë gjithë kësaj kohe, përse ishte e nevojshme që ata ti telefononin njëri tjetrit gjatë gjithë kohës, ditën dhe natën siç shihet në raportet e matjeve telefonike?

Për më tepër, siç është spjeguar më lart, Gjykata vlerësoi se pohimet e [redacted] me të cilat ai fajëson vetveten, [redacted] dhe [redacted] si të vërteta. Deklaratat e [redacted] mbështeten nga prova të tjera të cilat janë diskutuar në mënyrë të detajuar në pjesën E më poshtë. Dëshmia e [redacted] është në kundërshtim me deklaratat e [redacted] pa ofruar ndonjë spjegim të besueshëm apo mbështetje për versionin e tij të fakteve.

[redacted] gjithashtu kundërshton versionin e [redacted] për mbrëmjen e datës 03 shkurt 2010. Sipas [redacted] ka kërkuar që ai ti shoqërojë ata me makinë në shtëpinë e [redacted] për të parë makinën e re të [redacted]. [redacted] dëshmoi se [redacted] kishte kërkuar që ai ti shoqërojë ata me makinë tek shtëpia e [redacted]. Sido që të jetë puna, është e çuditshme dhe ndoshta e pabesueshme që [redacted] të ketë shkuar në shtëpinë e [redacted] pas kërkesës së [redacted] dhe pastaj [redacted] hjesht lënë [redacted] dhe [redacted] në rrugë pa hyrë në shtëpi. Gjithashtu duke marrë parasysh se [redacted] kishte lënë makinën e tij pas restorantit Tiffany dhe sipas dëshmisë së tij ai nuk kishte qenë kurrë më parë në shtëpinë e [redacted], është edhe më e çuditshme fakti që [redacted] braktis [redacted] aty duke i thënë se vjen dhe e merr më vonë vetëm nëse gjendet aty afër.<sup>34</sup> Dëshmia e [redacted] është ndoshta edhe më e dyshimtë nga fakti se pasi që ai është arrestuar në shtëpinë e [redacted] ai nuk ka bërë asnjë përpjekje për të kontaktuar [redacted] ndërkohë që bazuar në tregimin e [redacted] arsyeja e vetme për të cilën ai ishte në shtëpi, dhe për pasojë arsyeja e vetme për të cilën është arrestuar, ishte kërkesa e [redacted] për të ndihmuar [redacted] lidhur me vizën.

Për gjithë këto arsye, Gjykata vlerësoi dëshminë e [redacted] si jo të besueshme.

<sup>34</sup> Procesverbali i shqyrtimit kryesor, 02 shkurt 2011, p. 37.



5.

u deklarua "e pafajshme" për të dy akuzat dhe dëshmoi se as ajo as në asnjë mënyrë nuk kanë pasur të bëjnë me drogë.

Gjykata dyshon fuqimisht se ka qenë vërtet e përfshirë në aktivitet kriminal. Së pari, sipas , ka marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgatitjen dhe paketimin e marijuanës e cila ishte e vendosur në shtëpinë e tij. Së dyti, duke pasë parasysh se ajo nuk kishte familje apo shokë në Kosovë, Gjykata beson se më së pakti ajo ishte e pranishme me kur ky i fundit është përfshirë në këtë aktivitet ilegal. Sikur të ishte e vërtetë se ajo ka qendruar vetëm në hotel gjatë pjesës me të madhe të kohës, siç dëshmon , është e çuditshme që, bazuar në raportet e matjeve telefonike, nuk ekzistojnë thirrje telefonike apo mesazhe SMS mes dhe .

Megjithatë, pa asnjë provë mbështetëse, dëshmia e të bashkëakuzuarit nuk është e mjaftueshme për të shpallur fajtor të bashkëakuzuarin tjetër. Nuk është gjetur drogë kur ajo është arrestuar. Dhe as në makinën e saj nuk janë gjetur shenja droge, Passat 362-M-468.


Për këtë arsye, Gjykata duhet të lirojë nga të dy akuzat.

#### E. Gjetjet Faktike

Bazuar në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor dhe në pajtim me gjetjet mbi besueshmërinë siç është përshkruar më lart, Gjykata vlerëson faktet në vijim të vertetuara:

Në mes të tetorit të vitit 2009 dhe 3 shkurtit 2010, dhe ishin anëtarë të një grupi të organizuar kriminal së bashku me ca persona të tjerë të panjohur nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i grupit përbëhej nga transporti, shpërndarja dhe shitja e substancave narkotike për përfitim. Narkotikët u sollën nga Shqipëria në Kosovë prej nga u dërguan nëpërmjet Serbisë me destinim në Bosnje dhe Hercegovinë. veprroi si udhëheqës organizativ i grupit kriminal duke i koordinuar veprimet në mes të dhe dhe anëtarëve të tjerë të panjohur të grupit. dhe dy anëtarë shqiptarë të grupit të quajtur dhe komunikonin secili në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të telefonit mobil për të lehtësuar qëllimin kriminal të grupit të organizuar kriminal.

udhëhoqi dhe dy shqiptarët e quajtur dhe në sjelljen e marijuanës që përmban tetrahydrocannabinol (THC) në shtëpinë e Mustafës. pranoi të mbante substancat mbyllur në një dhomë në katin e dytë në shkëmbim të shumës së vogël prej 30-50 Euro për çdo dërgesë droge. Në të njëjtën dhomë, ka peshuar drogën me anë të peshores elektronike dhe pastaj i ripaketonte në qese më të vogla. Kjo ka ndodhur më shumë se një herë, nuk dihet se sa herë ka ndodhur e as nuk dihet sasia e përgjithshme e drogës që kaloi nëpërmjet shtëpisë së . Pas paketimit të drogës, kontaktonte i cili ka organizuar marrjen e kësaj droge. Ilte drogën në garazhin e shtëpisë



dhe persona të panjohur meshkuj të udhëhequr nga [redacted] merrnin drogën nga garazhi.

## F. Kualifikimi ligjor

### 1. Ligji i zbatueshëm

Veprimet kriminale janë kryer në mes të tetorit të vitit 2009 dhe shkurtit 2010. Në atë kohë, Kodi Penal i Kosovës (KPK) i cili hyri në fuqi më 6 janar 2009 ishte ligji i zbatueshëm. Në pajtim me Nenin 2, paragrafi (1), ligji në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve do të zbatohet për kryerësin.

### 2. Akuza për narkotikë

[redacted] dhe [redacted] u shpallën fajtorë për veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të substancave të rrezikshme psikotropike sipas nenit 229, KPK, paragrafi (2) që thotë:

Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë apo substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjetë.

Vendimi për përcaktimin e Listës së Narkotikëve<sup>35</sup> përcakton tetrahydro-cannabinolin (THC) si narkotikë.

Provat vërtuan se [redacted] dhe [redacted] kanë sjellur dhe transportuar marijuana që përmban substancën narkotike THC në shtëpinë e [redacted] me dijeninë dhe miratimin e këtij të fundit. [redacted] ka ofruar një vend të sigurt që grupi të vendosë dhe të ripaketojë drogën. Që të tre meshkujt morrën pjesë në transportin e drogës jashtë shtetësisë së [redacted] me qëllim që droga të transportohet jashtë Kosovës për në Serbi dhe Bosnje për shpërndarje dhe shitje.

Paragrafi (4) i nenit 229 thotë:

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në një apo në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:

1) Kryerësi vepron si anëtar i një grupi.

Në rastin aktual është përmbushur neni 4(1) ngase është vërtetuar se [redacted] dhe [redacted] vepruan si grup i organizuar kriminal së bashku me persona të panjohur shqiptarë (siç sqarohet më detalisht më poshtë).

<sup>35</sup> Nr. 1094, Këshilli Federal Ekzekutiv, 21 dhjetor 1978



### 3. Akuza për krim të organizuar

Neni 274, paragrafi (7) pika (2), KPK definojnë grupin e organizuar kriminal si:

Grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.

Provat vërtetuan se për rreth katër muaj, në mes të tetorit 2009 dhe shkurtit 2010, [redacted] dhe [redacted] vepruan në bashkëpunim duke organizuar transportin e drogës së paligjshme nga Shqipëria, nëpërmjet Mitrovicës për në Serbi/Bosnje dhe Hercegovinë me qëllim të përfitimit financiar. Grupi ishte i strukturuar dhe [redacted] kishte rol organizativ, [redacted] ofronte transportin dhe paketimin e drogës dhe [redacted] ofronte vendin për mbajtjen e drogës.

Pika (3) e paragrafit të njëjtë definojnë "krimin e rëndë" si veprë penale të ndëshkueshme me burgim prej së paku katër vjet. Siç u tha më lart, vepra penale e blerjes, posedimit, shpërndarjes, dhe shitjes së paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotropike është e dënueshme me një deri në tetë vjet burgim. Prandaj, dënimi me burgim prej së paku katër vjet është i mundshëm dhe vepra penale kualifikohet si krim i rëndë.

Për shkak të strukturës dhe qëllimit të një grupi të organizuar kriminal, vepra penale e krimit të organizuar mund të kryhet në mënyra të ndryshme dhe secili anëtar i grupit mund të bëjë veprime të ndryshme. Disa anëtarë mund të kenë rol më të madh dhe më të rëndësishëm se sa të tjerët, dhe ligji parasheh që personat që kanë përgjegjësi më të madhe në grup të dënohen në përputhshmëri me këtë përgjegjësi.

Neni 274 paragrafi (3) KPK thotë:


Kushdo që organizon, formon, mbikqyr, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

Është vërtetuar nga provat se [redacted] ka luajtur rolin e organizatorit të grupit dhe ka drejtuar aktivitetet e [redacted] dhe anëtarë të tjerë të panjohur të grupit. Për këtë arsye, ai shpallet fajtor për paragrafin (3) të nenit 274.

Neni 274 paragrafi (1) KPK thotë:

(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.

Është vërtetuar nga provat se të dy [redacted] dhe [redacted] kanë kryer krimin e rëndë të Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotropike duke vepruar si pjesë e një grupi të organizuar kriminal. Për këtë arsye, ata shpallen fajtorë lidhur me paragrafin (1) të nenit 274.



## G. Dënimi

Gjatë marrjes së vendimit për ndëshkimin penal, Gjykata duhet të ketë parasysh qëllimin e përgjithshëm të ndëshkimit – për të eliminuar aktivitete të rrezikshme për shoqërinë duke parandaluar që persona të tjerë të kryejnë vepra penale të ngjashme – dhe qëllimi i veçantë - për të parandaluar që kryesi të përsërisë veprën penale. Në këtë rast, Trupi Gjykues ka ardhur në përfundimin se qëllimi i dyfishtë i lartpërmendur mund të arrihet vetëm me zbatimin e dënimit me burg.

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjithë faktorët zbutës dhe rëndues, në patim me nenin 64 paragrafi 1 i KPK, duke mbetur brenda kufijve të dënimit të paraparë me ligj.

### 1. [Redacted]

Përsa i përket [Redacted] trupi gjykues ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se ai është i padënuar më parë. Trupi Gjykues ka vlerësuar si rrethanë rënduese kohëzgjatjen e veprës penale e cila ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme për disa muaj dhe faktin që [Redacted] e kishte joshur një të mitur – [Redacted] në veprim kriminal.

Për veprën penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrike në rastin kur ajo kryhet në grup, ligji parasheh një ndëshkim me gjobë dhe burgim me prej tre deri në 15 vjet. (Neni 229 Paragrafi (2) lexuar me paragrafin (4) të KPK-së. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, Trupi Gjykues vendosi ndëshkimin me gjobë prej 50.00 euro dhe tre vjet burgim për këtë veprim kriminal.

Për veprën penale të Krimin të Organizuar duke vepruar si organizator apo drejtues i aktiviteteve të një grupi të organizuar kriminal, ligji parasheh një gjobë dhe burgim prej shtatë deri në njëzet vjet. (neni 274 paragrafi (3) i KPK-së). Trupi Gjykues vendosi një ndëshkim me gjobë prej 50.00 euro dhe tetë vjet burgim për këtë veprim kriminal.

Duke pasur parasysh se i akuzuari ka kryer dy veprime kriminale, në pajtim me rregullat e përlllogaritjes për një dënim unik, dënimi unik duhet të jetë më i lartë sesa secili dënim individual por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të parapara. Për këtë arsye Gjykata caktoi dënimin unik me gjobë në shumën prej 51.00 euro dhe dhjetë vjet burgim në pajtim me nenin 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 dhe 4 të KPK-së.

I akuzuari është në paraburgim prej datës 22 shkurt 2010. Kjo perikudhë do të llogaritet si pjesë e kryer e dënimit në dënimin me burgim në pajtim me nenin 73 Paragrafi (1) i KPK-së.

### 2. [Redacted]

Përsa i përket [Redacted] trupi gjykues nuk ka mundur të gjejë rrethana lehtësuese për tu marrë parasysh. Trupi gjykues ka vlerësuar si rrethanë rënduese



kohëzgjatjen e veprës penale e cila ka ndodhur në vazhdimësi gjatë disa muajve dhe dënimin e tij të mëparshëm në shtator 2007 në Kroaci për "Trafikim me njerëz".

Përsa i përket veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrike në rastin kur ajo kryhet në grup, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues caktoi dënimin me gjobë 50.00 euro dhe tre vjet burgim.

Përsa i përket veprës penale Krim i Organizuar duke vepruar si anëtar i një grupi të organizuar kriminal, ligji parasheh dënim me gjobë dhe me të paktën shtatë vjet burgim (neni 274 paragrafi (1) i KPK-së). Trupi Gjykues caktoi dënimin me gjobë prej 50.00 euro dhe shtatë vjet burgim.

Gjykata caktoi dënimin unik me gjobë prej 51.00 euro dhe tetë vjet burgim në pajtim me nenin 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 dhe 4 e KPK-së.


I akuzuari është në paraburgim prej datës 03 shkurt 2010. Dënimi me burg përfshin periudhën e kaluar në paraburgim në pajtim me nenin 73 paragrafi (1) i KPK-së.

### 3. [REDAKTUAR]

Përsa i përket [REDAKTUAR], trupi gjykues vlerësoi si rrethana lehtësuese moshën e tij të re në kohën e veprës penale, faktin që ai deklarohet fajtor për akuzën për lëndë narkotike dhe faktin se ai ka shkuar vullnetarisht në polici për tu dorëzuar dhe ka siguruar detaje dhe prova kundër të bashkëakuzuarit tjetër duke dhënë mundësinë policisë dhe prokurorit që të bëjnë hetimin. Trupi gjykues vlerësoi si rrethanë rënduese kohëzgjatjen e veprës penale e cila ka ndodhur në vazhdimësi për disa muaj.

Në pajtim me paragrafin (2) të nenit 66 të KPK-së, Trupi gjykues mund të caktojë një dënim më të vogël sesa kufijtë e dënimit të paraparë me ligj në rastet kur ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke caktuar një dënim më të vogël. Në këtë rast, akti i [REDAKTUAR] për të shkuar vullnetarisht në polici për tu dorëzuar vetë dhe të tjerë përbën një rrethanë veçanërisht lehtësuese. Pa këtë hap fillestar nga [REDAKTUAR] policia dhe prokuroria nuk të kishin qenë në gjendje të hetonin veprat penale [REDAKTUAR] ka ditur se duke shkuar në polici ai do të fajësonte vetveten si dhe një mik të familjes dhe se kjo do të kishte pasoja. Ai ishte i motivuar që të ndryshonte sjelljen e tij kriminale nga fakti se ishte në pritje të fëmisë së tij të parë dhe i shqetësuar për pasojat që përfshirja e tij në drogë do të kishte në familjen e tij të re. Për këtë arsye, Trupi gjykues vendosi të caktojë për secilën veprë penale dënime më të ulëta sesa minimum i paraparë me ligj për këtë veprë. Megjithatë, zbutja e dënimit kufizohet nga nëni 67, paragrafi (1) pika (2) e KPK-së, i cili parasheh se për veprën penale që ndëshkohet me të paktën tre vjet, dënimi mund të zbutet në një vit.

Përsa i përket veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotropike në rastin kur ajo kryhet në grup, ligji parasheh dënim me gjobë dhe burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet (neni 229 paragrafi (2) lexuar me paragrafin (4) të KPK-së).





Përsa i përket veprës penale Krim i Organizuar duke vepruar si anëtar i një grupi të organizuar kriminal, ligji parasheh gjobë dhe të paktën shtatë vjet burgim (neni 274 paragrafi (1) të KPK-së).

Duke marrë parasysh faktorët veçanërisht lehtësues dhe në pajtim me nenin 66 dhe 67 të KPK-së, Trupi gjykues caktoi dënimin me gjobë 50.00 euro dhe dy vjet burgim për veprën penale, Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrike dhe dënim me gjobë prej 50.00 euro dhe tre vjet burgim për veprën penale Krim i Organizuar.

Prandaj, Gjykata caktoi dënimin unik me gjobë prej 51.00 euro dhe katër vjet burgim në pajtim me nenin 71 paragrafi (1) dhe paragrafin (2) pika 2 dhe 4 i KPK-së.

I akuzuari ka qenë në paraburgim prej datës 03 shkurt 2010 deri 21 prill 2010, dhe pastaj në arrest shtëpiak deri me datë 22 prill 2010. Kjo periudhë kohore do të llogaritet në dënimin me burg në pajtim me nenin 73 paragrafi (1) i KPK-së.

#### 4. Gjobat Detyruese


Tre të pandehurit e shpallur fajtorë për veprat penale janë dënuar në pajtim me udhëzimet detyruese të KPK-së. Për veprën penale Krim i Organizuar, KPK-ja parasheh dënim të detyrueshëm me gjobë dhe burgim (neni 274, paragrafi (1) dhe (3) i KPK-së). E njëjta gjë vlen edhe për veprën penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrike (neni 229 paragrafi (4) lexuar me paragrafin (2) të KPK-së). Trupi gjykues ka shprehur mospajtim të thellë me ligjëvënësin lidhur me caktimin e të dy dënimeve, gjobë dhe burgim, për secilën veprë penale duke pasur parasysh dënimet e rënda të caktuara dhe gjendjen ekonomike të familjeve të secilit prej të akuzuarve. Për këtë arsye, trupi gjykues caktoi gjobën më të ulët të lejuar nga ligji – 50.00 euro për secilën veprë penale dhe 51.00 euro si dënim unik.<sup>36</sup>

#### H. Kërkesat e Refuzuara

Me datë 8 dhjetor 2010, Trupi gjykues refuzoi kërkesën e avokatit mbrojtës Mahmut Halimi për të deklaruar deklaratën e dëshmitares [redacted] dhënë në polici me datë 15 mars 2010 si të papranueshme. Trupi Gjykues vlerësoi se [redacted] nuk ishte e liruar nga detyrimi për të dhënë dëshmi sipas nenit 160 paragrafi (1) pika 2, dhe për këtë arsye nuk ishte detyrim që të jepej një paralajmërim i tillë përpara intervistës. Ky vendim është shpallur me datë 08 dhjetor, dhe është nxjerrë edhe aktvendimi me shkrim bashkë me arsyetimin e detajuar.

Me datë 05 janar 2011, Trupi gjykues refuzoi kërkesën e avokatit mbrojtës Mahmut Halimi për të dëgjuar [redacted] si dëshmitar për faktin se ai ishte avokati mbrojtës i [redacted] gjatë fazës paraprake dhe në këtë mënyrë ai ishte dëshmitar i privilegjuar. Megjithatë, më vonë gjatë gjykimit, pas kërkesës së Prokurorit Publik dhe me mbështetjen dhe pajtimin e [redacted] është thirrur dhe ka dëshmuar me datë 10 shkurt 2011.

<sup>36</sup> Neni 39, paragrafi (1) KPK.



## I. Sendet e Konfiskuara

26.449 kg kanabis dhe 4.342 kg të substancës në formë pluhuri ngjyrë kafe e hapur (që përmban një përzierje Acetaminofenin/Paracetamol dhe kafeine) të sekuestruara në shtëpinë e [redacted] dhe 7,530 Euro dhe 230 BiH Marks (KM) të sekuestruara [redacted] konfiskohen në pajtim me nenin 60 paragrafi (1) i KPK-së dhe neni 494 i KPPK-së.

Shuma prej 1,600 euro e sekuestruar nga [redacted] kthehet asaj për shkak se ajo është liruar nga të gjitha akuzat.

## J. Shpenzimet

Meqënëse, [redacted] dhe [redacted] janë shpalluar fajtorë, ata duhet të paguajnë pjesën e tyre të shpenzimeve të procedurës në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) i KPPK-së, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një vendim e veçantë për shumën e shpenzimeve do të nxirret nga Gjykata pasi të merren këto të dhëna në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) i KPPK-së.

Për shkak të lirimimit të [redacted] nga të gjitha akuzat, në pajtim me nenin 103 paragrafi (1) i KPPK-së, shpenzimet e procedurës nga neni 99 paragrafi (2) nënparagrafi 1 përmes 5 të KPPK-së, shpenzimet e saj të nevojshme, pagesën, shpenzimet e nevojshme të avokatit të saj mbrojtës si dhe shpenzimet e përkthimit paguhen nga buxheti.

## Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P. nr. 36/2010

Përpiluar në anglisht, gjuhë e autorizuar.

Tara Khan  
Procesmbajtëse

Hajnalka Veronika Karpati  
Kryetare e Trupit Gjykues

Jonathan Welford-Carroll  
Anëtar i Trupit Gjykues

Caroline Charpentier  
Anëtare e Trupit Gjykues

Keshillë Juridike:

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë më shkrim kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të një kopjeje të këtij Aktgjykimi në pajtim me nenin 398 paragrafi (1) të KPPK.

